



Tirana, Albania

KONKURS NDËRKOMBËTAR PËR PROJEKTIM PEISAZHISTIK

THIRRJE PËR PROJEKT-IDE

Faza I: 06 Nëntor 2015

PARKU I BESIMIT NË TIRANË

KOPSHTË MEDITIMI E SODITJEJE PËRGJATË BULEVARDIT
“DËSHMORËT E KOMBIT” FRYMËZUAR NGA LIBRAT E SHENJTË DHE
BASHKEJTESA FETARE



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

AKPT
AGJENCIA KOMBETARE E
PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT



TEMAT E REFERENCËS

Promovues

Atelier Albania, me kërkesë të Bashkisë Tiranë, Ministrisë së Zhvillimit Urban, Ministrisë së Kulturës, dhe mandatuar nga Zyra e Kryeministrit, shpall një konkurs ndërkombëtar për projektim peisazhistik, frymëzuar nga vlera më fisnike ajo e harmonisë fetare, vlerë të cilën shqiptarët e ndajnë me njëri-tjetrin dhe botën, e fokusuar në hapësirat e hapura përgjatë Bulevardit “Dëshmorët e Kombit”, duke u shpërndarë gjithandej në hapësirat publike kryesore të kryeqytetit.

Manifesto

Bulevardi përfshin hapësira të mundshme që mund të strehojnë një varg ndërhyrjesh në peisazh, frymëzuar nga librat e shenjtë, por jo vetëm. Qëllimi kryesor i këtij konkursi është përfitimi i projekt-ideve që do të transformojnë hapësirat lineare të hapura, si dhe xhepa të tjerë të gjelbër përgjatë bulevardit, në pasqyrime peisazhistike, që simbolizojnë vlerat kulturore më fisnike, që shqiptarët transmetojnë nëpërmjet besimit, i cili nuk është i lidhur vetëm me harmoninë fetare, por gjithashtu dhe me harmoninë në përgjithësi. Kjo është një mundësi unike për të përmirësuar hapësirat publike qendrore të qytetit përmes ndërhyrjeve në projektimin dhe konceptimin e peisazhit, të cilat synojnë komfort shpirtëror dhe meditim.

“...M'u duk me vend sot dita, për t'ju përcjellë idenë e ndërtimit në Tiranë, së shpejti, të një “Parku të Besimit”. Një hapësirë publike, e gjelbër, e mbjellë me të gjitha bimët, lulet dhe pemët që përmenden në Kuran dhe në Bibël (dhe libra të tjerë të shenjtë). Në këtë park, kushtuar bashkëjetesës, fëmijët, prindërit, gjyshet dhe gjyshërit e kryeqytetit, apo të qyteteve të tjera shqiptare dhe po ashtu, vizitorët e huaj, do të mund të gjejnë jo vetëm të gjithë krijesat e gjelbra të librave të shenjtë, por edhe imazhe, objekte, tinguj që i bëjnë jehonë kësaj historie dhe pasurie të paçmuar shqiptare, për të cilën, përlusisht, çdo shqiptar, duke filluar nga Shteti shqiptar, nga të gjitha institucionet dhe autoritetet shqiptare, duhet t'i jetë mirënjohës komuniteteve fetare të këtij vendi...”

Edi Rama

Nëpërmjet kësaj thirrjeje të hapur Atelier Albania synon të ftojë ekipet e arkitektëve dhe arkitektëve të pejsazhit që do të gjenerojnë propozime origjinale projektimi, duke vlerësuar kontekstin ekzistues social-kulturor të vendit.

“Parku i Besimit”, i frymëzuar nga vlerat e përmendura në Shkrimet e Shenjta dhe nga harmonia fetare që ekziston në Shqipëri, sigurisht një vlerë e trashëguar ndër breza, synon gjetjen e një koncepti të ri të “të së përbashkëtës” dhe “strehës”. Përmes shtresave të ndryshme të përjetimit, parku do të ofrojë hapësira jo vetëm për grupmosha, kombësi, fe dhe profesione të ndryshme, por gjithashtu do të ofrojë hapësira të atmosferave të ndryshme. Bazuar në vlerën e bashkëjetesës, do të krijohet një biodiversitet i ri urban dhe nga hapësirat publike të bulevardit dhe qytetit, do të lind një koncept i ri për jetesën.

Përfituesit

Ky konkurs ndërtohet mbi temën e besimit dhe harmonisë fetare, duke qenë vlera që shqiptarët do të donin t’i shfaqnin dhe ndanin me të gjithë botën.

“...Shqipëria ka përvojën e vëllazërisë fetare dhe ... harmonia fetare në vend është një model për t’u ndjekur në mbarë botën...”

“...Dhe kjo është të jesh partizan i paqes dhe kungimimit mes vëllazërish dhe rregulli parësor i të cilit fetar apo jo, është që të përpiqemi për të përputhur ndërgjegjet tona...”

“... Shqipëria e vëllazërisë fetare është e vendosur të vazhdojë të mbajë lartë flamurin e lirive, e të drejtave, flamurin e barazisë mes të gjitha opinionëve dhe besimeve...”

Edi Rama

Nëpërmjet këtij konkursi do të arrihet një cilësi tjetër e hapësirave publike, të cilat do të përdoren jo vetëm nga qytetarët e Tiranës që si mesdhetarë kalojnë një kohë të konsiderueshme jashtë. Parku do të jetë i aksesueshëm edhe nga vizitorët që mund të udhëtojnë për të mësuar për Shqipërinë dhe kulturën shqiptare e veçanërisht mund të përjetojnë harmoninë fetare që na perkufizon ne midis shumë vlerave të tjera.

Autoritetit Kontraktues

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit është Autoriteti Kontraktor për këtë proces, me kërkesë të Ministrisë së Zhvillimit Urban, Bashkisë së Tiranës dhe Ministrisë së Kulturës.

Zona e Konkursit

Zona e konkursit, e cila është subjekt i hartimit të projekt-ideve, shfaqet në hartën e vendndodhjes së konkursit dhe përfshin një grup hapësirash të hapura/publike, të pozicionuara në anë të Bulevardit “Dëshmorët e Kombit”. Për më tepër, synimi i konkursit përfshin hapësira të tjera të mundshme si hapësira publike, kopshte dhe parqe të qytetit. Qendra e “Parkut të Besimit” në Tiranë do të jetë hapësira publike që mbështjell “Piramidën”, me vetë ‘Piramidën’ si pikënisje dhe destinacion. Ndaj në këtë kuptim, ‘Piramida’ do të bëhet subjekt i propozimeve. Vendodhjet e tjera janë të vendosura përgjatë segmentit që lidh sheshin “Skënderbej” me sheshin “Nënë Tereza”. Përveç kësaj, një komponent i rëndësishëm i këtij konkursi është edhe shtrimi i hapësirës së kalimit dhe dizenjimi urban i vetë bulevardit.

“...Konkursi i Parkut të Besimit që ka në qendër piramidën dhe të gjitha hapësirat gjelbëra ku synojmë të krijojmë një imazh të prekshëm të harmonisë fetare të vendit tonë ku janë të përfshirë dhe të gjithë ata që nuk besojnë. Ky park do të sjellë të gjitha lule, bimët e pemët që janë të përmendura në librat e shenjtë të besimeve...”

Edi Rama

Qëllimi i Konkursit / Pyetja e Konkursit

Konkursi do të ndërtohet dhe përgjigjet këtyre çështjeve kryesore:

- Si të gjesh zgjidhje nëpërmjet projektimit peisazhistik që siguron vazhdimësinë e hapësirës peisazhistike dhe urbane përgjatë bulevardit?
- Si të zhvillosh një projekt-ide pejsazhi, frymëzuar nga cilësitë e kopshteve të përmendura në librat e shenjtë dhe nga bimësia dhe atmosferat e përshkruara në dorëshkrimet e shenjta, por edhe nga tipari i bashkëjetesës fetare që karakterizon popullin shqiptar?
- Si të gjesh mënyra që garantojnë një seri hapësirash publike që ofrojnë vende, ku përjetohen përvoja të ndryshme kolektive, dialogu dhe meditimi?
- Si të përmirësosh nga ana estetike dhe të dizenjosh në mënyrë efektive infrastrukturën e shtrimit të rrugës, e cila mund të balancojë dhe t’i jap prioritet mënyrave të ndryshme të lëvizjes (asaj aktuale dhe të ardhshme - duke përfshirë lëvizjen për këmbësorë, çiklist, tranzit, makina) që mbështetet në konceptin e përgjithshëm të ndërhyrjes në peisazh
- Si të përfshish strukturën e ‘Piramidës’ në konceptin e ‘Parkut të Besimit’; si ta trajtosh atë si pikënisje dhe destinacion për qytetin e Tiranës; si ta shdërrosh ‘Piramidën’ në qendrën e jetës publike, diskursit, kulturës e bashkëjetesës (të gjitha këto vlera që do të na ndihmojnë të integrohemi në Bashkimin Evropian)? A mund të shdërrohet struktura e ‘Piramidës’ në një qendër të Evropës në Shqipëri dhe si?

Objektivi

Produkt i konkursit do të jetë Projekti i Pejsazhit për “Parkun e Besimit në Tiranë”, i vendosur në hapësirat e dhëna përgjatë Bulevardit “Dëshmorët e Kombit”, si dhe nëpër xhepa të tjerë të mundshëm nëpër qytet . Ky konkurs është në kërkim të një strategjie të mirëfilltë të pejsazhit, që do të përmirësojë cilësitë fizike dhe estetike të hapësirave publike, si dhe do të sigurojë një park linear meditimi e soditjeje me shumë xhepa. Kjo strategji duhet të ofrojë një ambient ftues të dëshirave, që komunikon mesazhin e paqes dhe dialogut. Ekipet pjesëmarrëse pritet të sjellin projekt-ide origjinale dhe zgjidhje të frymëzuara nga përshkrimet e pejsazhit në dorëshkrimet e shenjta, si edhe nga harmonia fetare që karakterizon shqiptarët. Konkursi synon të krijojë një lidhje të fortë midis hapësirave publike të shfrytëzueshme në jetën e përditshme në një qytet mesdhetar dhe pejsazhit “të shenjtë” ose atij të meditimit. Propozimet për projekte duhet të përqendrohen në rëndësinë e ofrimit të hapësirave kolektive narrative, të cilat theksojnë harmoninë në përgjithësi dhe harmoninë fetare, dhe shërbejnë si platforma për dialog dhe ndërlidhje.

Konkurentët që do të përzgjidhen në fazën e dytë, për të dhënë propozimet e tyre do t’u kërkohet të punojnë, për të arritur si më poshtë:

- Të studiojnë mbi Shqipërinë, shqiptarët dhe kulturën e tyre fetare;
- Të studiojnë zonën e konkursit dhe rrethinat e saj në aspektin e programit hapësinor dhe kontekstit socio-kulturor;
- Të studiojnë hartën e vegjetacionit dhe “rrjetit” të gjelbër të zonave të hapura përgjatë Bulevardit “Dëshmorët e Kombit”;
- Të analizojnë dhe përmirësojnë vendet e përshtatshme për parkun e ri tematik;
- Të studiojnë në mënyrë të posaçme se si programi i parkut lidhet me kontekstin, duke siguruar një integrim të harmonizuar me ndërtesat ekzistuese;
- Hulumtim mbi atmosferat, bimësisin dhe peisazhin, e përshkruara në dorëshkrimet e shenjta;
- Propozim i një plani të dizenjimit të peisazhit të “Parkut të Besimit në Tiranë”;
- Parashikim të kostove të propozimi;
- Propozim i një plani veprimi;
- Propozim i një projekt-ideje për shtrimin e Bulevardit “Dëshmorët e Kombit”;
- Rikonceptimi i dizenjimit të hapësirës së kalimit të bulevardit dhe bërja e tij pjesë e vizionit të pejsazhit, që siguron transformimin më të rëndësishëm qytetar. Është thelbësore që të kemi një propozim të integruar me pjesë e transportit dhe zonave publike;
- Propozim i strategjisë për aktivizimin e terrenit, i menduar të jetë funksional në të gjitha stinët, si dhe dizenjimi i mobiljeve urbane, që i përkasin të njëjtit lloj/familje;
- Propozim i aktivizimit të strukturës së ‘Piramidës’ si pikënisje dhe destinacion i ‘Parkut të Besimit’; si qendra e Evropës në Tiranë;

- Të konsiderojnë bimësinë ekzistuese me pemë pishe shumëvjeçare përgjatë Bulevardit dhe t'i bëjnë pjesë të vizionit dhe strategjisë së tyre për dizënjimin e ardhshëm;
- Hulimtim mbi mënyrën se si Parku i Besimit mund të jetë i mirë-integruar dhe koherent, që të konceptohet si një hapësirë e vetme, por me një përjetim përvojash të ndryshme përgjatë korridorit të Bulevardit (p.sh. pjesëza kundrejt të tërës);
- Si të përforcojnë marrëdhënien me Lumin e Lanës ose ujin (në kuptimin fizik dhe simbolik, dhe – a ka ndonjë mundësi për të përmirësuar Bulevardin aty ku ai kalon përmes Lumit Lana?);
- Promovim i zhvillimit të qëndrueshëm dhe inovativ.

Metodologjia

Atelier Albania është një njësi e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, e mandatuar për identifikimin e zgjidhjeve alternative dhe pasurimin e arkitekturës e planifikimit nëpërmjet të menduarit përtej kornizave. Në këtë kontekst ne stimulojmë dhe mbështesim pjesëmarrjen e grupeve me profesionistë ndërkombëtarë që do të punojnë së bashku me profesionistë vendas. Ne besojmë se ky bashkëpunim me bazë ekipi do të pasurojë mënyrën sesi informohet projekti me të gjitha njohuritë e nevojshme lokale dhe ekspertizën e nivelit të lartë të projektimit. Për më tepër, ne duam të eksperimentojnë një proces konkursi bashkë – krijues, ku projektuesit dhe disa aktorë lokalë janë të përfshirë në një proces interaktiv përzgjedhës.

Formati i konkursit është eksperimental në mënyrë që të kapërcehen ato që AA beson se janë çështje të pandara të proceseve tipike të konkurseve urbane dhe të arkitekturës.

Rezultatet e pritshme

FAZA 1:

Në këtë fazë të short-listimit, kandidatët paraqesin veten e tyre duke ilustruar kapacitetet e tyre, metodologjinë dhe vizionin ndaj subjektit të konkursit. Çdo dorëzim do të shqyrtohet me kujdes nga anëtarët e jurisë dhe ekipet do të përzgjidhen bazuar në kriteret e kualifikimit dhe të vlerësimit të përmendura në Fazën 1.

Mes ekipeve të kualifikuara Juria do të short-listojë ekipet që plotësojnë kriteret e përzgjedhjes së Fazës I. Këto ekipe do të thirren për të punuar gjatë një faze të dytë, për një koncept që do të synojë plotësimin e objektivit të konkursit dhe pyetjeve të konkursit, mbi bazën e një informacioni dhe të një detyre projektimi të detajuar.

FAZA 2:

Në fazën e “Projekt-Idesë”, çdo propozim do të analizohet me kujdes nga anëtarët e jurisë dhe, bazuar në kriteret e vlerësimit të Fazës 2, do të përzgjidhet një propozim fitues.

Bashkimi i skuadrave vendase me të huajat

Çdo ekip ndërkombëtar stimulohet nga organizatorët për t'u lidhur në partneritet me një ekip vendas dhe çdo ekip lokal për t'u lidhur gjithashtu me një partner ndërkombëtar. Atelier Albania beson se një bashkëpunim i tillë mund të rrisë ndikimin e propozimit dhe të përmirësojë zbatimin e projektit. Megjithatë, në thirrjen për fazën e parë, nuk është kusht përzgjedhje që ekipet të kenë një partner lokal apo ndërkombëtar.

Klienti beson se ky bashkëpunim mund të rrisë impaktin e propozimit dhe të përmirësojë cilësinë e zbatimit. Gjatë aplikimit për fazën e parë nuk është kriter përzgjedhës që ekipet të kenë një partner vendas apo ndërkombëtar; megjithatë, të kesh një partneritet në këtë fazë është pozitive dhe mund të ndihmojë për krijimin e një vizioni më koherent dhe të kontekstualizuar, i cili sigurisht mund të rrisë shancet e ekipeve për përzgjedhje.

Përshtatshmëria

Konkursi është i hapur për të gjithë profesionistët arkitektë, të cilët arrijnë të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

1. të jenë të regjistruar apo të njohur nga një organ zyrtar akreditimi në vendin e origjinës së aplikantit; ose
2. atje ku njohja apo regjistrimi nuk aplikohen me ligj, aplikanti të jetë anëtar i një institucioni profesional, në vendin e origjinës.

Të gjithë aplikantët duhet të japin dëshmi të vlefshmërisë së regjistrimit profesional, njohjes apo anëtarësimit, në Deklaratën e Përbërjes së Skuadrës.

Secili prej ekipeve të Fazës 1 duhet të ketë në përbërje:

- arkitekt pejsazhi,

Të gjithë anëtarët e skuadrës duhet të identifikohen në Deklaratën e Përbërjes së Skuadrës.

Detajimet jepen në shtojcën 6 të DST, e cila mund të shkarkohet në adresën www.app.gov.al

Dokumente Aplikimi

Konkurentët duhet të dorëzojnë një seri me dokumente, në mënyrë që të jenë në përshtatje me kërkesat e konkurimit për fazën e parë dhe të dytë të konkursit. Dokumentet janë të karakterit ligjor-informativ. Detajimet në lidhje me dokumentet që duhen dorëzuar jepen në shtojcën 6 të Dokumentit Standart të Tenderit (DST). Ndërkohë më poshtë jepet vetëm një listë e shkurtër e tyre.

Dokumentet e Fazës 1:

- Deklarata e Përbërjes së Skuadrës,
- CV të Stafit Primar,
- Metodologjia,
- Deklarata e Vizionit
- Të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme sipas përcaktimeve standarte të Agjencisë së Prokurimit Publik (shtojca 6 e DST)

Dokumentet e Fazës 2:

- Ide Projektimi sipas Termave të Referencës dhe kërkesave të Autoritetit Kontraktor

Kriteret e Kualifikimit

Juria do t'i zgjedhë aplikantët që do të vlerësohen gjatë fazës së parë bazuar mbi këto kriteret fillestare kualifikimi:

- Qartësia dhe plotësimi i dokumenteve të kërkuara në Fazën 1
- Përbërja profesionale e skuadrës (arkitekt, arkitekt pejsazhi, artist ose artist pamor, botanist ose specialist në njohjen e bimëve, teolog, preventivues)
- Eksperiencat e ngjashme të studios dhe stafit kyç
- Qartësia dhe efikasiteti i metodologjisë së propozuar
- Lidhja e vizionit të prezantuar me zgjidhjen e problematikave të përcaktuara në konkurs

Detajimet jepen në shtojcën 6 të DST

Kriteret e Vlerësimit

Juria do të vlerësojë aplikimet e Fazës 2 bazuar në kriteret e mëposhtme:

- *Krijimtaria*
- *Përshtatshmëria e propozimit me funksionin e kërkuar*
- *Faktori i lartë i zbatueshmërisë së idesë së projektimit*
- *Lidhje dhe impakti i propozimit me kontekstin*
- *Raporti kosto-impakt (kosto e ulët, impakt i madh)*

Produkti Final

Konkursi do të përfundojë me zgjedhjen e një ekipi. Ekipi fitues duhet të jetë një ekip i mirë-pajisur, i cili do të jetë në gjendje të angazhohet në procesin pas-konkurs.

Ekipi fitues do të angazhohet në fazën vijuese, e cila konsiston në përgatitjen e projektit të zbatimit, e bazuar në propozimin fitues.

Procesi Post-Konkurs

Për të koordinuar më mirë punën mes skuadrës fituese dhe porositësit të projektit, organizatorët parashikojnë 1 takim mes skuadrës, klientit dhe grupeve të interesit, gjatë procesit të detajimit të projekt-idesë. Koncepti këtu është që aktorët të vijnë së bashku për të ndarë idetë, propozimet dhe sugjerimet e tyre, nën kujdesin e anëtarëve të Jurisë dhe institucioneve të specializuara. Ky takim do të realizohet në Tiranë.

Çmimet e Konkursit

Fituesi i konkursit do të vlerësohet me një çmim në vlerë monetare 30,000 Euro.

Skuadra fituese do të nisë negociatat me klientin për përgatitjen e projektit të zbatimit, bazuar në propozimin fitues.

Platforma e Konkursit

Lloji I Konkursit:	Konkurs Projektimi me Short-Listim
Faza 1:	Thirrje e Hapur për Shprehje Interesi
Kërkesat e Fazës 1:	Sipas Shtojcës 6 të Dokumentit Standart të Tenderit
Avantazh:	Bashkimi i studiove vendase dhe ndërkombëtare të Arkitekturës
Vlerësimi i Jurisë:	Lista e skuadrave të kualifikuara – ‘Lista e Shkurtër’
Faza 2:	Projekt-idea
Kërkesat e Fazës 2:	Dorëzimi i materialeve ilustruese të Projekt-Idesë
Fazë e ndërmjetme:	Vizitë në terren dhe workshop me ‘aktorët’ vendas
Vlerësimi i Jurisë:	Propozimi më i mirë që plotëson kriteret e konkursit
Çmimet:	Çmimi për fituesin 30, 000 Euro dhe Lidhja e Kontratës së projekt zbatimit

Kalendari i Konkursit 2015

Thirrje e hapur për shprehje interesi:	15 Tetor
Afati Faza 1:	06 Nëntor , ora 10.00
Lista e Shkurtër:	09 Nëntor
Ftesë për Projekt-Ide:	16 Nëntor
Përgatitja e Projekt-Idesë:	16 Nëntor - 21 Dhjetor
Workshop në Tiranë:	23 Nëntor
Detyra finale e Projektimit + Plani i hapave:	16 Nëntor
Afati Faza 2:	21 Dhjetor, ora 18.00
Prezantimet Publike:	22 Dhjetor
Vlerësimi i Jurisë:	22 Dhjetor
Shpallja e Fituesve:	22-23 Dhjetor

Pas-Konkurs 2015

Negociatat e Kontratës	Janar 2016
Firmosja e Kontratës për Studimin e Fizibilitetit:	Janar 2016
Procesi i përgatitjes së Studimit të Fizibilitetit:	2016
Takime me AA/Jurinë dhe Grupe Interesi:	Janar - Shkurt 2016
Dorëzimi i Projektit të Zbatimit:	2016

INFORMACIONE PROKURIMI

Faza e shortlistimit do të kryhet nëpërmjet sistemit elektronik në ndërfaqen me adresë: www.app.gov.al.

Dokumentet e tenderit mund të përftohen elektronikisht në po këtë ndërfaqe: www.app.gov.al.

Konkurentët e huaj, në mënyrë që të përdorin sistemin elektronik të prokurimit, duhet të regjistrohen on-line si një operator ekonomik në ndërfaqen: <https://www.app.gov.al/ep/Registration.aspx>.

Instruksione të mëtejshme për konkurentët ndërkombëtarë mund të merren nga manuali i përdoruesit "EPS user manual – Economic Operators", i cili mund të shkarkohet nga ndërfaqja www.app.gov.al.

INFORMACIONE TË MËTEJSHME

Secili prej Termave të Referencës mund të gjenden edhe në faqen zyrtare të Organizatorit të Konkursit:
<http://www.planifikimi.gov.al>

Apo, në faqet e dedikuara për këto Konkurse:
<http://competitions.planifikimi.gov.al/faithpark/>

Mund të na kontaktoni edhe në:
atelieralbaniacompetitions@planifikimi.gov.al

Sqarimet lidhur me procedurën e prokurimit do të kërkohen vetëm nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.



AKPT
AGJENCIA KOMBETARE E
PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT



Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
Adresa: Rr. "Muhamet Gjollësja", Nr. 57
Kutia Postare 1023, Tiranë/ Shqipëri

www.planifikimi.gov.al
info@planifikimi.gov.al